



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME KAMËZ S.H.A

Nr. 1340 Prot.

Kamëz, më 31/05 / 2024

DETYRE PROJEKTIMI

OBJEKTI: HARTIM I PROJEKT PREVENTIVIT PER OBJEKTIN
“REHABILITIM KUN-JE RR ARGJINATURA DERI TEK AZILI I PLEQVE L=1208ML”

KAMEZ 2024

Adresa: Rr. “Paqësori”, Frutikulturë, Kamëz, Tel:042222999, email:info@ukk.al. ëeb:ëëë.uk.al

1. VENDODHJA

Zona e Projektit është lagjia Kamez I gj.5 ,Bathore 5,6,7, ndërtimet në këtë zonë janë bërë pas viteve 90.

Infrastruktura nëntoksore e Ujësjetesit është Investuar nga KFË-ja dhe kanalizimet janë pjesore të kryera në mënyrë private dhe jo sipas kushteve teknike.



2. QELLIMI I PUNES

Qëllimi i detyrës së projektimit është hartimi i projekt- preventivit të zbatimit të objektit :

“Rehabilitim Kun-je Rr Argjinatura deri te Azili i Pleqve (Rr Teuta)”

Investimet në ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve të ujrave të ndotura dhe ujësjetesit në zonën e Bashkisë Kamëz do të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimit, siç është vazhdimësia e shërbimit dhe në uljen e shpenzimeve operative të kompanisë Ujësjetes Kanalizime Kamez (UKK). U.K.K synon të hartojë projekt-zbatimin për ndërhyrjet në rrjetin e ujrave të ndotura dhe ujësjetesit veçanërisht në këtë. Në këto segmente aktualisht nuk ka rrjet kryesor të KUZ dhe KUB. Ujërat e ndotura derdhen në kanal të hapur i cili përshkon kanalin kryesor ku përbën rrezik infeksioni për popullatën e zonës dhe më gjerë, gjë që e bën aktualisht situatën tejet problematike. Projekti për ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza (KUZ) do t'i hapë rrugë kryerjes së një sërë investimesh infrastrukturorë në këtë zonë.

Për shkak të konfigurimit të terrenit ku shtrihet zona e Kamzes dhe Bathores është menduar që

të gjithë shkarkimet të mblidhen gjatë gjithë gjatësisë dhe të transportohen në drejtim të kolektorit të Rr. Teuta.

Me planin e mësipërm i jepet zgjidhje përfundimtare problemit të ujrave të ndotura të kësaj zone, duke siguruar një rrjet ujrash të ndotura tërësisht funksional, modern si dhe në përputhje me standartet më të larta të kërkuara. Gjithashtu pasi të perfundojë investimi kostot e mirembajtjes së UKK do të reduktohen ndjeshëm.

Gjendja e përgjithshme e rrjetit do të përmirësohet, duke zvogeluar ndjeshëm numrin e nyjeve në tubacion që do të prishen, duke ulur dhe kostot e tjerat të lidhura me to.

3. NEVOJAT PER REALIZIM

Ndërtim i rrjetit Kun-je Rr Argjinatura deri te Azili i Pleqve (Rr Teuta) bëhet me qëllim të përmirësimit kushtet sanitare dhe mjedisore në këtë zonë.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është ndërtimin e kësaj linje e cila plotëson nevojat e banorëve të kësaj zonë për shkarkimin e ujërave të ndotura.

4. GJENDJA EKZISTUESE

Zona e cila është objekt i projektit ka një rrjet të amotizuar kanalizimesh , dhe një pjesë e zones funksionon me gropa skeptike dhe një pjesë e madhe i shkarkojne derdhur ne kanalin kryesor të hapur duke u bere burim infeksionesh për banorët e zonës.

Infrastruktura e kanalizimeve në këtë zonë është në një gjendje jo të mire, edhe pse performanca e UKK sh.a. është përmirësuar dukshëm gjate ketyre viteve te fundit. Problem është edhe zhvillime te reja urbane, duke perfshire ndertesat e ligjshme dhe te paligjshme, një pjesë e tyre nuk janë të mbuluara nga sistemimi i rregullt i kanalizimeve.

Rrjeti i kanalizimeve te ujrave te zeza ne zonën e Valiasit të Vjetër është në gjendje shumë të keqe, pasi shkarkimi kryesor mungon dhe derdhjet nga zona behen ne kanal te hapur ne një gjatesi prej 1208 ml, duke u bere burim infeksionesh per banoret. Popullsia e projektuar e zones ku do te ndertohet rrjeti kryesore i KUZ është perllogaritur rreth 2,000 banorë banore rezidente dhe jorezidente per arsye te levizjes se popullsisë ne emigracion.

Sipërfaqja e zones se trajtuar është rreth 43 ha.

Per te përmirësuar kushtet ekzistuese sanitare dhe per te shmangur rreziqet potenciale per shendetin e popullates lokale Ujesjelles Kanalizime Kamez sh.a ka vendosur qe te beje te mundur "Rehabilitim Kun-je Rr Argjinatura deri te Azili i Pleqve (Rr Teuta)".

5. TE DHENAT PER PROJEKTIM

Projektuesi duhet të bëjë hartimin e e projekti-preventivit me gjithë detajet e nevojshme. Projektuesi do kete te gjithë te dhenat e nevojshem qe ka ne dispozicion Ujesjelles Kanalizime Kamez sh.a. per realizimin e projektit.

Perspektiva e rrjetit te kanalizimeve dhe ujësjellësit te parashikohet per 25 vjet;

Kanali magjstral te jete me tuba B/A .

Te merret në konsideratë planimetria e rrjetit ekzistues;

Të merret në konsideratë perespektiva 25 vjeçare e rritjes së popullsisë;

Të kihet në konsideratë ruajtja e rrjetit ekzistues (nëse ka) që ka kapacitetin e mjaftueshëm përcjellës dhe është në gjendje të mirë punë.

Drejtimi i zhvillimit urbanistik të zonës do të merret në Bashki.

Projektuesi duhet te percaktoje dhe piken e shkarkimit te ujerave te ndotura.

Hartimin e planit të organizimit, të përcaktojë teknologjinë e hapjes së trasese dhe makineritë e nevojshme duke marë parasysh dhe mundësinë e hapjes së fronteve rezervë për shpejtimin e punimeve.

6. KERKESAT QE DUHET TE ZGJIDH PROJEKTI

- Projekti duhet te zgjidhë problemin e shkarkimit te ujerave te ndotur dhe permiresimin e kushtet sanitare dhe mjedisore ne kete zone.
- Projekti duhet te hartohet me shkarkimin e ujerave te ndotur me veterrjedhje.
- Te merret ne konsiderate traseja egzistuese.
- Projektuesi te marre ne konsiderate anen gjeologjike te trasese ku do kalohet linja.
- Projektuesi duhet të hartojë projektin e zbatimit të pusetave te mundshme gjate trasese .
- Projektuesi të hartojë preventivin përfundimtar të punimeve për çdo nënobjekt duke pasur parasysh edhe çmimet sipas VKM-së në fuqi.
- Projektuesi duhet të hartojë grafikun e punimeve dhe përcaktimin e kohëzgjatjes e punimeve për këtë vepër.
- Projektuesi duhet të hartojë profilat gjatesore , terthore , specifikimet teknike per te gjitha zerat e parashikuara ne preventivin e punimeve nga ana e tij.

7. REALIZIMI I PROJEKTIT

Të kryhet hartimi i Projekt-Zbatimit preventivat se bashku me grafikun e punimeve të objektit:

“Rehabilitim Kun-je Rr Argjinatura deri te Azili i Pleqve (Rr Teuta)”

i cili duhet te permbaje:

- Relacioni teknik.
- Hartimi i relievit topografik të zonës ku do të ndërhyhet (kordinata lokale ose kuota absolute)
- Planimetrine e zbatimit të plotë të traseve te linjave .
- Profilin gjatësor dhe tërthor të të gjithë linjave të skemës.
- Hollësitë ndërtimore , planimetri , prerje ,detajet teknike , betonimi , armimi ,mbeshteset e tubacionit dhe detaje te ndryshme .
- Specifikimet teknike për zërat e punimeve që do të kryhen.
- Preventivi dhe grafiku i punimeve.

8. RAPORTIMI

I gjithë dokumentacioni do të paraqitet në 3 (tre) kopje orgjinale, dhe ne 1(nje) CD.

Llogaritjet, specifikimet teknike dhe preventivi.

Relacioni teknik qe shoqeron projektin duhet te permbaje:

- Llogaritjet hidraulike
- Preventivin e plotë i veprës; Preventivi i objektit të hartohet duke u mbështetur në çmimet manualit në fuqi.

9. STANDARTET

Standarte në projektim.

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektimin që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i standarteve dhe normave përkatëse. Projektuesi duhet të rekomandojë dhe prezantimin e standarteve të reja, për përafrimin me normat e BEsë, si edhe të praktikave me të mira ndërkombëtare në projektin dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të realizueshmërisë me praktikën shqipëtare dhe limitimet për financimin e veprës.

Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik.

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës. Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihet parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për Planifikimin e Territorit”, Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi. Me anën e këtij raporti teknik të sqarohen investigimet e bëra nga projektuesi për gjendjen egzistuese, kushtet teknike dhe kriteret e projektimit llogaritjet përkatëse për mënyrën e furnizimit me ujë. Gjithashtu të jepen përshkrime për fazat e ndërhyrjes dhe rehabilitimit të sistemit, ,specifikimet teknike për materialet si dhe proceset e punimeve që do të kryhen, vizatimet e nënobjekteve, që do të ndërtohen (planimetri, profila, prerje, hollësi ndërtimore ,detaje teknike etj), si dhe volumet kryesore të punimeve dhe materialeve ,makinerive e pajisjeve që duhen për kryerjen e kësaj ndërhyrjeje për ndërtimin e këtij ujesjellësi dhe për zgjidhjen përfundimisht të problemit të furnizimit me ujë për sot dhe perspektive.

10. PARTNERET DHE FINANCUESIT E PROJEKTIT

-Shoqëria Ujesjelles Kanalizime Kamez sh.a

Grupi i punes :

1.Ing.Bardhok Alia

2.Ing.Edison Kolgjini

3.Ing.Dritan Nuzi

4.Ing.Mensur Hysa

ADMINISTRATOR**Eris MARTINI**